



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-14268
Dt.09.06.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Faton (Fadil) Leniqi** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm, me etazhitet B+P+4, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: Faton (Fadil) Leniqi nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm, Sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban të Komplexit Urbanistik, potezi përgjatë rrugës regjionale “Gjakovë – Prizren” dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07/351/01-702 të datës 27.01.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 20/1, ZK: Zidi i Sadik Agës II, në pronësi (qirambajtje për 99 vite) të lartë përmendurit, në rrugën “Gaspër Karaqi”, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është B+P+4, në sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit prej **S=2606.43 m²**

Bodrumi:	(Sip.Bruto):	S=412.50 m ²
Përdhesa:	(Sip.Bruto):	S=412.50 m ²
Kati i parë:	(Sip.Bruto):	S=453.90 m ²
Kati i dytë:	(Sip.Bruto):	S=430.00 m ²
Kati i tretë:	(Sip.Bruto):	S=430.00 m ²
Kati i katër:	(Sip.Bruto):	S=430.00 m ²
Kulmi shkallët:	(Sip.Bruto):	S= 37.53 m ²

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim - objekt banimor shumë banesor, me afarizëm, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë byroja projektuese “Korona ING” - Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve;

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Ar sy e t i m

Faton (Fadil) Leniqi nga Gjakova, me banim në rrugën “Gjergji Fishta”, pn, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-14268, dt. 05.06.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm, me etazhitet B+P+4, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 20/1, ZK: Zidi i Sadik Agës II, në pronësi (qirambajtje për 99 vite) të lartë përmendurit, në rrugën “Gaspër Karaqi”, siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 , të datës 20.01.2017, i punuar nga NPSH”GELI”-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 18.01.2017, në pronësi të Faton (Fadil) Leniqi, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndës 189/17 të datës 18.01.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit banimor shumë banesor në me afarizëm, në ngastrën kadastrale me nr. 20/1 :ZK: Zidi i Sadik Ages II, me nr. 07/351/01-702, të datës 27.01.2017.
5. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr. 08-320/01-7446/17, dt.04.04.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Gjakovës.
6. Raporti mbi kërkimet gjeomekanike në teren si dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e objektit afaristo banesor, me Investitor Fadil Leniqi nga Gjakova, në ngastrën kadastrale me nr.20/1, të hartuar nga “GEO-test Ing”-Suharekë.
7. Pëlqimin Sanitar, me nr 14/530/01-13656 të datës 05.06.2017, nga Inspektoriati Sanitar komunal-Drejtoria për Punë Inspektuese.
8. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.110/17, me datë 31.05.2017, lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme e R.K.S.
9. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-L-196 të datës 18.01.2017.
10. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, dt. 13.02.2017.
11. Pëlqimin nga K.R.U.”Radoniqi”Sh.A.-Gjakovë, të datës 01.02.2017.
12. Pëlqimin nga PTK-Sh.A.Gjakovë, të datës 39.01.2017.
13. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Raiffeisen Bank, filiala në Gjakovë, të datës 08.06.2017.
14. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga byroja projektuese “Korona ING” - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 9320.27 Euro.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit ,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur.dipl.

U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.


KOPJE PLANI

Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë

Shk. zvog. 1: 1000

Zona kad. Z.K. Zidi Sadik Ages II

Poseduesi: 1 /1 Leniqi Faton (Fadil) qirambajtje 99 vite



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
20-1	-	-	kullosë	2	0	15	27	
Gjithësejtë					0	15	27	


Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

VËRTETON:

Arber Jusufi

K. GJAKOVË
Z.K. : Z.S.A.
Parc. nr. 20-1

PLAN SITUACIONI



LOKACIONI :
FATON LENIQI
S = 415m²

20.01.2017
GPS
Auto CAD 2004

P=1:500

Punoi : *Shkelq F. Zhuti, insh.dipl.i gjeed.*

Vërtetoi : N.P.SH."GELI"
DREJTORI

Fred Hajdaraj